



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA  
GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:204035

Datë: 05.09.2024

Numri i dokumentit: 06127156

C.nr.3423/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Uran Zogaj, me praktikantin D.H. në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.G. nga fshati ..... Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Avokatëve “Arbëresh”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, vlera e kontestit 5,500.00 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë 05.09.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**  
në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia

I. REFUZOHET e pabazuar kërkesëpadia e paditësit A.G. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, me të cilën ka kërkuar që të “OBLIGOHET e paditura Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, që paditësit, në emër të të gjitha formave të dëmit material he jomaterial, t’ia kompensoj shumën prej 5,500.00 euro, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 11.09.2022, me kamatë ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm dhe të OBLIGOHET e paditura që paditësit t’ia paguajë të gjitha shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyqimit nën kërcënim të ekzekutimit të detyrueshëm”.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësi A.G. nga fshati .... Komuna e Prizrenit, të cilin me autorizim e përfaqëson av. D.M. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padinë, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve “Siguria”, me seli në Prishtinë, të cilën me autorizim e përfaqëson Kompania e Avokatëve “Arbëresh”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit kompensim i dëmit, vlera e kontestit 5,500.00 euro.

Lidhur me këtë çështje juridike kontestimore, përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse, av. D.M. me parashtrësën C.nr.3423/2022 e datës 29.08.2024, ka njoftuar gjykatën se heqin dorë nga kërkesëpadia në këtë çështje juridike kontestimore, pasi që palët kanë arritur marrëveshje jashtëgjyqësore dhe gjykatës i ka propozuar që të nxjerr aktgjykim në bazë të heqjes dorë nga kërkesëpadia.

Mbi këtë bazë, gjykata vlerëson se janë plotësuar kushtet që të refuzohet kërkesëpadia e paditësit, në përputhje me nenin 149 të LPK-së.

Numri i lëndës: 2022:204035

Datë: 05.09.2024

Numri i dokumentit: 06127156

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në kuptim të nenit 450 të LPK-së, që secila palë t'i bartë shpenzimet e saj procedurale.

Nga sa u tha më lartë, konform dispozitave ligjore të parapara me nenin 149 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN  
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil  
C.nr.3423/2022 të datës 05.09.2024

Gj y q t a r i  
Uran Zogaj

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate Themelore.